



Datë: 11.12.2025
Numër Protokolli: 7928/2025

A.nr.1209/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Hava Fekaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1209/2025, të datës 24.06.2025, të parashtruar nga ankuesit V.Sh-K, S.H, I.K, B.S, A.B, B.M, E.M, S.K, A.P dhe T.R, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Shëndetësisë, në çështjen juridike “*kompensim material*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 dhe 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Pezullohet procedura administrative e filluar sipas ankesës me numër A.nr.1209/2025, të datës 24.06.2025, lidhur me ankuesit V.Sh-K, S.H, B.S, A.B, B.M, E.M, S.K dhe A.P.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1209/2025, të datës 24.06.2025, lidhur me ankuesit T.R dhe I.K.

III. Lënda lidhur me ankuesit si në pikën II të dispozitivit, i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje Komisionit për Ankesa në Ministrinë e Shëndetësisë.

A r s y e t i m

Ankuesit V.Sh-K, S.H, I.K, B.S, A.B, B.M, E.M, S.K, A.P dhe T.R, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit), më datë 24.06.2025, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.393/V/2025, të datës 27.05.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë.

Sipas shkresave të lëndës rezulton se sipas Vendimit me Nr.104./V/ 2024, të datës 17.05.2024, të Ministrit të Shëndetësisë, është emëruar Komisioni për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale në këtë përbërje: V.K- AKKPM, kryesuese, B.S, AKKPM, anëtar, I.K- ShSKUK, anëtar, H.S – ShSKUK, anëtar, L.Sh, ShSKUK, anëtar, S.H, AKKPM, anëtare, B.S, ShSKUK, anëtar, K.M, FSSH, anëtare, ndërsa, si Sekretari teknike e këtij komisioni janë caktuar: B.M, MSh; T.R, MSh; S.K, MSh; A.B, MSh; dhe A.P, MSh.

Me tej, sipas provave materiale të çështjes del së më datë 06.05.2025, ankuesja V.K në cilësi të kryesues së Komisionit për caktimin e çmimeve për produkte medicinale, në emër të komisionit ka parashtruar kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, për kompensim të funksionit shtesë

për anëtarët dhe sekretarinë teknike të këtij komisioni. Ndërsa, ky i fundit më Vendimin Nr.393/V/2025 të datës 28.05.2024, ka refuzuar kërkesën për funksion shtesë me arsyetimin se zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë të cilët shërbejnë në borde, komisionit dhe trupa tjerë profesionale nuk marrin kompensim për angazhimin e tyre në këto trupa.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë se kanë të drejtë në kompensimin e shtesës në emër të funksionit shtesë për shkak të angazhimit në komisionin për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, duke ju referuar kështu dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Rregullores Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksioneve Shtesë dhe duke ju referuar edhe Vendimit A.nr.2012/2024 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kërkojnë që të aprovohet ankesa dhe të obligohet Ministria e Shëndetësisë që të bëjë kompensimin për funksion shtesë në mënyrë retroaktive nga data e emërimit e deri në zbatimin e këtij vendimi.

I. Kolegji i Këshillit duke u bazuar në provat e lëndës konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për pezullimin e procedurës administrative lidhur me ankuesit si në pikën I të dispozitivit, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesit si në pikën I të dispozitivit kanë statusin e nëpunësit civil, në atë mënyrë qe: V.K sipas Akt Emërimit me numër protokolli 767, të datës 07.03.2025, mbanë pozitën Drejtor në Departamentin e Autorizim Marketingut, në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, ankuesja S.H sipas Akt Emërimit me numër protokolli 2932, të datës 05.07.2017, mbanë pozitën Zyrtare e Lartë Shqyrtuese, në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, ankuesi B.S sipas ndryshimit dhe plotësimit të Aktit të Emërimit mbanë pozitën Zyrtar i Lartë i Divizionit të Licencimi, në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, ankuesja A.B-V, sipas Akt Emërimit me numër protokolli 05-10046 të datës 23.12.2024, mbanë pozitën Zyrtare e Lartë për Farmaci, në Ministrinë e Shëndetësisë, ankuesja B.S-M, sipas Akt Emërimit me numër protokolli 05-10056, të datës 23.12.2024, mbanë pozitën Zyrtare e Lartë për Farmaci, në Ministrinë e Shëndetësisë, ankuesi S.K, sipas Akt Emërimit me numër protokolli 05-10047, të datës 23.12.2024, mbanë pozitën Zyrtar i Lartët për Farmaci në Ministrinë e Shëndetësisë, ankuesja A.P sipas Akt Emërimit me numër protokolli 05-78, të datës 09.01.2025, mbanë pozitën Zyrtare e Lartë e TI-së për Baza të të Dhënave, në Ministrinë e Shëndetësisë, ankuesi E.M, sipas aktit të Emërimit AE.nr.42/2024, të datës 21.03.2024, mbanë pozitën Inspektor Farmaceutik.

Marrë parasysh së objekti i ankesës ka të bëjë më kompensim për funksion shtesë dhe duke qenë së Këshilli për çështja të njëjtë dhe institucion të njëjtë, më Vendimin A.nr. 32/2024 të datës 23.02.2024, kishte refuzuar ankesën e ankuesve R.H, J.G, H.S, T.A. Sh.U.H dhe A.M, vendim ky i anuluar nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Administrative më Aktgjykimin A.nr.1411/2024, të datës 27.08.2025, e më të cilin aktgjykim është detyruar Ministria e Shëndetësisë që ankuesve t'i bëjë kompensimin në emër të angazhimit për punë shtesë si kryesues dhe anëtarë të trupave profesionale. Këshilli, kundër aktgjykimit A.nr.1411/2024, të datës 27.08.2025, ka parashtruar ankesë më datë 03.11.2025 në Gjykatën e Apelit, më të cilën konteston Aktgjykimin A.nr.1411/2024, të datës 27.08.2025, për shkak të shkelje të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Andaj, mbi këto rrethana, dhe duke qenë së aktgjykimi A.nr.1411/2024, i datës 27.08.2025, nuk është përfundimtar pasi që Këshilli ka ushtruar ankesë kundër të njëjtit, Kolegji në mbështetje të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *“Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: “çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja*

paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit”, vendosi për pezullim të procedurës të iniciuar sipas ankesës A.nr.1209/2025, të datës 24.06.2025, lidhur me ankuesit V.Sh-K, S.H, B.S, A.B, B.M. E.M, S.K dhe A.P.

Procedura do të mbetet e pezulluar deri në vendimin përfundimtar lidhur me çështjen administrative/ gjyqësore A.nr.1411/2024.

Duke u bazuar si me lartë dhe në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit si në pikën II të dispozitivit, **sepse:**

Nga provat e lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi T.R sipas Kontratës të Punës për Kohë të Pacaktuar me numër protokoli 1268 të datës 01.09.2020, është e punësuar në pozitën Zyrtare e Farmacisë në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, ndërsa, ankuesi I.K sipas Kontratës së Punës për Kohë të Pacaktuar me Nr. 28/2025 të datës 16.05.2025, është i punësuar në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Konteste Juridike në Departamentin Ligjor të ShSKUK-së.

Në kuptim të kompetencës së Këshillit për vendosje, Kolegji i Këshilli duke u bazuar në nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 2.16 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, konstaton se të punësuarit në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, janë të përjashtuar nga fushëveprimi i ligjit për zyrtarët publikë, e për rrjedhojë, të njëjtë nuk kanë statusin e nëpunësit civil. Ndërsa, duke u bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, të punësuarit duke përfshirë zyrtarët e nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të institucioneve publike shëndetësore të Republikës së Kosovës kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik, kështu që, duke qenë se ankuesit T.R dhe I.K, nuk kanë statusin e nëpunësit civil, Kolegji në mbështetje të nenit 6, paragrafi, 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konstaton se KPMSHCK-ja nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueseve si në pikën II të dispozitivit.

Rrjedhimisht, duke qenë Ligji Nr. 04/L-249 për Sigurime Shëndetësore, nuk ka rregulluar të drejtën e ankesës së stafit të Fondit për Sigurimeve Shëndetësore, Kolegji iu referua nenit 78 dhe 79 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës ku shprehimisht thuhet se: **Neni 79, paragrafi 1 “... 1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. Neni 79 paragrafi 1: Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente...”** si dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se : *Nëpunësi i shërbimit publik dhe nëpunësi teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë tek Komisioni i Ankesave i themeluar nga punëdhënësi, për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e punës. Qeveria pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor përcakton procedurën dhe rregullat për themelimin, përbërjen dhe mandatin e Komisionit të Ankesave”,* Andaj, nisur nga ky përcaktim ligjor

dhe duke qenë së Komisioni për caktimin e çmimeve të produkteve mediconale është themeluar në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, Kolegji bazuar në autorizimet sipas nenit 75 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje Komisionit për Ankesa në Ministrinë e Shëndetësisë, e më pastaj pala mund të parashtroj padi pranë gjykatës kompetente.

Thënë si më lartë, e duke u bazuar nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si pikën II dhe III të dispozitivit.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1209/2025

Hava FEKAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesve V.Sh-K, S.H, I.K, B.S, A.B, B.M, E.M, S.K, A.P dhe T.R;
- Komisionit për Ankesa në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Njësisë së Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së.